



Federata Aeronautike e Kosovës

RREGULLORJA PËR PJESËMARRJE NË GARAT KOMBËTARE TË ORGANIZUARA NGA FAK

Kryesia e Federatës Aeronautike të Kosovës në mbledhjen e vet të mbajtur më 04.03.2015, aprovoi:

RREGULLOREN 01/2015

PJESËMARRJE NË GARAT KOMBËTARE TË ORGANIZUARA NGA FAK, DISCIPLINA PARAGLLAJDIZËM

Neni 1.

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret për pjesëmarrje të pilotëve në garat kombëtare të organizuara nga FAK.

Neni 2.

Në garat e organizuara nga FAK mund të marrin pjesë të gjithë pilotët anëtarë të ndonjë klubi të anëtarësuar në FAK të cilët janë të licensuar si pilotë nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës ose nga ndonjë autoritet tjetër ndërkombëtarë i aviacionit.

Neni 3.

Organizatori i garës kombëtare (FAK), është i obliguar të publikoj në internet kriteret dhe rregulloret për secilën garë në të cilën FAK figuron si organizator ose bashkë-organizatorë.

Neni 4.

Të gjithë pilotët pjesëmarrës në garat kombëtare të organizuara nga FAK, me pjesëmarrjen e tyre në garë në mënyrë automatike pajtohen me të gjitha kriteret dhe rregulloret e caktuara të garës përkatëse që organizohet nga FAK.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 5.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj, pra ndryshimet propozohen nga komisioni për paragllajdzëm në kuadër të FAK si dhe dëgohen për votim në kryesinë e FAK.

Neni 6.

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, 04.03.2015

Kryetari i FAK
Fadil Gërguri

Kryetari i komisionit për paragllajdzëm
Ardall Celina